

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i cili me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit ka planifikuar mbajtjen e trajnimit si më poshtë.

SHPALLJE

Në bazë të kësaj shpallje ftohen kompanitë/individët e interesuara për paraqitjen e ofertave të tyre për mbajtjen e trajnimit sipas temave dhe kushteve të specifikuar në vijim.

Objekti i shpalljes: Mbajtja e trajnimeve me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit.

Nr	Titulli i trajnimit	Përshkrim i llojit të trajnimit	Grupi i synuar	Numri i grupeve	Numri i pjesëmarrësve në grup	Kohëzgjatja në ditë për grup	Numri total i ditëve
1	Marketing, promovim dhe shitje	Strategjitë e promovimit dhe marketingut për IMF, shkathtesitë e prezantimit, shitja direkte etj.	Analist Kreditor/Menaxher dege /Pergjegjes dege	2	12-15	1	2
2	Raporti me klientë	Trajnim për shkathtësi të buta: komunikim efektiv, kujdes ndaj klientëve, menaxhim i kohës dhe stresit etj.	Analist kreditor dhe staf tjetër	2	12-15	1	2

Oferta për aplikim duhet të përmbajë:

1. Të dhënat për kompaninë/institucionin/individin (mbajtësi i trajnimit),
2. Të dhënat kontaktuese (adresën elektronike, numrin e telefonit, webfaqe, etj),
3. Detaje rreth modulit të trajnimit,
4. Referencat për punë të ngjashme (të preferuara ato nga sektori financiar)
5. Certifikata e kompanisë nëse ofertuesi është person legal,
6. Të dhënat për trajnerët (CV-të), përfshirë certifikatat që dëshmon se është i certifikuar si trajner apo ka përvoja relevante në fushat përkatëse,
7. Oferta financiare dhe afati për kryerjen e punës si me lartë (e preferushme nga muaji Maj-Qershor)
8. Çmimet duhet të jenë me TVSH dhe për ditë të trajnimit.
9. Trajnimet janë parapare të mbahen në klase dhe në zyrat e degeve të KRK-s.

Afati i dorëzimit të ofertave: nga dt. **31.05.2023 deri 06.05.2023**. Afati i implementimit të trajnimeve: Qershor 2023

Kompanitë e interesuara mund t'i dërgojnë ofertat e tyre në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com apo në zyrën e KRK, Rr.Behije Dashi Nr. 20, Prishtinë. Nëse keni nevojë për sqarime shtesë mund të na shkruani në adresën elektronike: krk_imf@krk-ks.com. Zgjedhja e kompanisë/institucionit/individit (mbajtësi i trajnimit) fitues do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertave nga komisioni duke marrë në konsiderim kualitetin, çmimin dhe afatin e propozuar për mbajtjen e trajnimeve.

Titulli i email-it tuaj duhet të përmbajë mbishkrimin “Aplikim për trajnime”